



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Datë	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

PËR MATERIALET ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET PËR KRYETARIN E BASHKISË
KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në referim të nenit 99 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë, para datës së zgjedhjeve, materialet zgjedhore të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim hartohet në kuadër të përgatitjeve, të zhvillimit dhe të administrimit të procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kukës që do të zhvillohen në datën 24 Shtator, dhe ka për qëllim të përcaktojë karakteristikat e materialeve zgjedhore që do të përdoren, si dhe dokumentacionin e punës.

Materialet zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kukës, do të plotësojnë karakteristikat e përcaktuara në vendimin nr. 223, datë 7.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim”.

Për vendosjen e materialeve zgjedhore do të përdoren kutitë e votimit, kapaku i të cilave do të jetë i vulosur me kodin e pestë nga KQZ dhe të identifikuar me shenja dalluese si kuti të materialeve zgjedhore.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim

projektvendimi “Për materialet zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

Danjela Alimemeti – Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Madalena KOJA - Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA – Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Aurel LAMÇE - Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve
Mbështetëse**

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**MATERIALET ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË
KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe të nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, do të përdoren materialet zgjedhore që plotësojnë karakteristikat e përcaktuara në vendimin nr. 223, datë 7.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim”.
2. Për vendosjen e materialeve zgjedhore do të përdoren kutitë e votimit, kapaku i të cilave do të jetë i vulosur me kodin e pestë nga KQZ dhe të identifikuar me shenja dalluese si kuti të materialeve zgjedhore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 2023 Nr:
Ora:



“Për materialet zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.